

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar i kolegjit, Tonka Berishaj dhe Have Haliti, anëtar të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sadik Kryeziu, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit Z.V., për shkak të veprës penale –krime lufte kundër popullsisë civile nga nenet 142 lidhur me nenin 22 të KPRSFJ-së, aktualisht të sanksionuar me nenin 152 dhe 153 të KPK-së, që korespondon me nenin 3 të përbashkët të katër Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe neneve 4,5 (1) dhe 13 të Protokollit II të 8 qershorit 1977, shtesë të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Z.V., av. N.V., ankesën e të akuzuarit Z.V. si dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit Z.V., av. N.V. të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.54/17 të datës 25.05.2018, pas mbajtjes së seancës së kolegjit konform nenit 390 të KPPK, me datë 30 janar 2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Refuzohen si të pabazuara ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ankesat e mbrojtësit të akuzuarit Z.V., av. V.N. dhe e akuzuarit Z.V., kurse aktgjykimi Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.54/17 të datës 25.05.2018, në pjesën dënuese-dispozitivi nën pikën II, vërtetohet.

II.Me aprovimin e ankesës të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, aktgjykimi i përmendur në pjesën liruese-dispozitivi nën pikën I, anulohet dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.54/17, të dt.25.05.2018, të akuzuarin Z.V., konform nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile, të parashikuara dhe të dënueshme me nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ-së, aktualisht të sanksionuar nga nenet 31,152 dhe 153 të KPK-së, në kundërshtim me nenin 3 të përbashkët të katër konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe

neneve 4,5 (1) dhe 13 të Protokollit II të 8 Qershorit 1977, konventave të Gjenevës të vitit 1949, ndërsa e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile, të paraparë dhe të parashikuar me nenet 21 dhe 142 të KPRSFJ-së, aktualisht të sanksionuar me nenet 31,152 dhe 153 të KPK-së, në kundërshtim me nenin 3 të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe nenet 4,5 (1) dhe 13 të Protokollit II të 8 qershorit 1977, shtesë Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vite e 6 (gjashtë) muaj. Në dënimin e shqiptuar i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 10 mars 2016 e tutje. I akuzuari është obliguar që ti paguajë pjesërisht shpenzimet e procedurës penale në shumë paushalle prej 300 €, kurse pjesa tjetër e mbetur ka rënë në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Palët e dëmtuara janë udhëzuar në kontest të rregullt juridik-civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

-Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovojë si të bazuar ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta anuloj vetëm për pjesën liruese, dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, ndërsa për pikën e aktgjykimit ku gjykata ka marrë aktgjykim dënues, të shqiptoj dënim më të lartë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit N.V., aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën dënuese e ankimon për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj si të bazuar ankesën e mbrojtjes dhe të vërtetoj aktgjykimin në pjesën liruese, ndërsa për pjesën dënuese propozon që ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin ta lirojë nga akuza.

-I akuzuari Z.V., për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe atij ti shqiptohet një dënim më i butë ose të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

-Përgjigje në ankesën e prokurorit ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit, av. N.V., me propozim që ankesa e prokurorit të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë sa i përket pjesës liruese të vërtetohet, kurse pjesa dënuese të ndryshohet apo çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën PPA/I.nr.447/18, të dt.11.10.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale, dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket pjesës liruese dhe i akuzuari të shpallet fajtor, kurse për pjesën dënuese ka propozuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i lartë me burg, ndërsa ankesa e të akuzuarit, ankesa e mbrojtësi të akuzuarit si dhe përgjigja në ankesë e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohen si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, në cilën prezantuan: I dëmtuari Sh.G., i akuzuari Z.V. dhe mbrojtësi i të akuzuarit av. N.V., ndërsa në seancë munguan : Prokurori i Apelit, dhe të dëmtuarit: S.K., S.H., S.O., H.A., A.G., M.U., S.G., Sh.B., B.M., F.P., S.K., S.K., V.K.-M., I.M., L.M., M.M., S.G., I.F., D.F., B.F. dhe G.H., edhe pse ishin të njoftuar në mënyrë të rregullt për kohën e mbajtjes së seancës, ndërsa mungesën nuk e arsyetuan, andaj seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK, në mungesë të tyre.

I dëmtuari Sh.G. theksoi se e mbështet ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe kërkon kompensimin e dëmit.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av. N.V., pasi që bëri disa sqarime mbeti në tersi pran ankesës dhe propozimit të dhënë në ankesë. I akuzuari Z.V. e mbështet mbrojtësin e tij dhe mbetet pranë ankesës së tij të paraqitur me shkrim dhe nuk ka çfarë të shtoj më shumë.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar edhe sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Për pjesën dënuese të aktgjykimit ankesa e prokurorit dhe ankesat e mbrojtësit të akuzuarit dhe të akuzuarit, nuk janë të bazuara, kurse për pjesën liruese të aktgjykimit ankesa e Prokurorit është e bazuar, ndërsa përgjigjja në ankesën e prokurorit e mbrojtësit të akuzuarit e pabazuar.

Gjykata e Apelit ankesat do ti shqyrtojë sipas renditjes në dispozitiv të këtij aktgjykimit ashtu që në pjesën e parë do të shqyrtohen ankesat për pjesën dënuese të aktgjykimit (dispozitivi I- akuza nr. III) dhe në pjesën e dytë ankesa e Prokurorisë Speciale përkitazi me pjesën liruese të aktgjykimit (dispozitivi II-akuza nr. I).

I.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë në pjesën dënuese nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë drejtim konform nenit 394 par.1 të KPPK-së dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat detyrimisht do të kishin kushtëzuar prishjen e tij.

Vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike.

Për sa i takon bazës ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, mbrojtësit e të akuzuarit në ankesën e tij, në esencë kontestojn mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet që i ka nxjerrë ajo në bazë të provave që i kishte proceduar lidhur me elementet e

veprës penale si: shkeljes së rëndë të drejtës humanitare ndërkombëtare, veprime skajshmërisht përçmuese dhe degraduese në formë të shkeljeve të integritetit trupor ose shëndetit dhe shkakimit të vuajtjeve të mëdha. Sipas ankesës këto epitete në lidhje me veprimet që janë objekt i aktakuzës dhe aktgjykimit dënues nuk qëndrojnë, përfundimet e gjykatës janë të tepruara, të ashpra dhe të padrejta për të akuzuarin. Prandaj, sipas ankesës vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike ka rezultuar edhe me zbatimin e gabuar të drejtës materiale, domethënë Kodit penal dhe konventës së Gjenevës, që aplikohet në këtë rast.

Ndërsa në ankesën e të akuzuarit lidhur me gjendjen faktike në mënyrë specifike kundërshtohet vlerësimi i dëshmive të dëshmitarëve S.K. dhe R.A. nga gjykata e shkallës së parë dhe konkludimi i saj në faqen 15 të aktgjykimit të ankimuar lidhur me kushtet çnjerëzore në cilat janë mbajtur të dëmtuarit sa ishin të paraburgosur, duke theksuar se ai nuk ishte organ vendimmarrës e as që ka pasur kompetencë për të vendosur ose në çfarëdo mënyre të ndikojë për ato kushte. Sipas ankesës të akuzuarit gjykata e shkallës së parë ia ka falë besimin deklaratës të dëshmitarit S.K., i cili ka pohuar se i akuzuari të njëjtin e ka goditë me shkop të metaltë, edhe pse ky fakt nuk përmendet nga dëshmitarët tjerë dhe gjykata nuk e merr parasysh faktin se po të ishte përdorur ky mjet atëherë lëndimet do të ishin shumë më serioze. Lidhur me dëshminë e dëshmitarit R.A., kundërshtimin e tij e bën në formë të pyetjes se si është e mundur që i dëmtuari i tij të ketë numëruar 150 goditje duke pasur parasysh faktin se me secilën goditje intensiteti i dhimbjes rritet dhe në këtë mënyrë do të pengojë në numërimin e atyre goditjeve.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara. Në fakt, ashtu si u tha edhe më lartë, mbrojtësi i të akuzuarit në mënyrë të përgjithshme pretendon se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka vërtetuar gjendjen faktike që ka rezultuar me konkludime të gabuara, mirëpo nuk jep arsye specifike se në çka konsistojnë gabimet e gjykatës që kanë ndikuar në përfundime të gabuara.

Mirëpo, nga shikimi i aktgjykimit të ankimuar del se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e mbështetë në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor të cilat i ka vlerësuar ashtu si e obligon dispozita e nenit 361 të KPPK-një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundime të drejta dhe të ligjshme të cilat në tersi i mbështetë edhe kjo Gjykatë.

Pra, gjykata, duhet pa tjetër t'i vërtetojë saktë dhe plotësisht të gjitha faktet relevante të çështjes konkrete në të cilat mbështetet aktgjykimi. Konsiderohet se faktet janë të vërtetuara në mënyrë të plotë, po qe se gjykata pas vlerësimit të gjitha provave të administruara, konsideron se faktet ekzistojnë dhe se nuk ka fare dyshim për ekzistimin e tyre.

Sipas përshkrimit faktik nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar (aktgjykimi dënues-aktakuza III) del se të akuzuarit i vihet në barrë:” se i akuzuari në mes 3 majit dhe fillimit të qershorit 1999, në cilësinë e tij si policë rezervë nga stacioni i policisë së Vushtrrisë,

atëherë duke vepruar si roje burgu, duke vepruar qëllimisht dhe në bashkëkryerje me pjesëtarët tjerë të forcave Serbe, ndërsa një numër i madh i popullatës civile etnike shqiptare u mbajti në paraburgim në Burgun e Smrekovicës, Rajoni i Mitrovicës, përfshirë S.K.n, B.F., M.U., F.P., B.M., Sh.B., G.H., A.O., Sh.M., S.Rr., R.A., iu nënshtruan trajtimit çnjerëzor dhe vuajtjeve të pafundme përmes shkakimit të rrahjeve, shkeljeve të integritetit trupor dhe shëndetit sikur edhe zbatimin e masave të frikësimit dhe terrorit.”

Këtë gjendje faktike gjykata e shkallës së parë e mbështetë në provat e drejtpërdrejta (deklarimet e dëshmitarëve) dhe njoftimet e siguruar nga Tribunali i Hagës lidhur me faktet e vërtetuara nga Dhoma Gjyqësore të Tribunalit të Hagës (në rastin Millutinoviq e tj.) të cilat janë administruara në shqyrtimin gjyqësor.

Kështu, gjykata e shkallës së parë faktin lidhur me ndalimin e shqiptarëve në objektet e burgut të Smrekovicës, e mbështetë në njoftimet gjyqësore nga Tribunali i Hagës për faktet e vërtetuara nga Dhoma Gjyqësore të Tribunalit të Hagës në rastin Millutinoviq dhe në këto rrethana dhe ky njoftim është administruar si provë në shqyrtimin gjyqësor. Tribunali i Hagës në rastin e përmendur vërteton faktet :” ...ndërmjet 1 dhe 3 majit forcat e MUP-it e ndanë kolonën në tri grupe. Grupi i parë, i përbërë nga gra, fëmijë dhe të moshuar që kishin automjete, u dërguan në Shqipëri, grupi i dytë, i përbërë nga gra, fëmijë dhe të moshuar që nuk kishin mjete transporti, u dërguan në fshatrat e afërt, në mes tyre Kiçiq dhe Dobërlluke, ndërsa grupi i tretë, që përmbante kryesisht meshkuj të moshës ushtarake, u dërguan në Burgun e Smrekovicës, ku u arrestuan dhe u keqtrajtuat. Pas arrestimit në kushte të mjerueshme përreth 3 javëve, të burgosurit u dërguan në kufirin shqiptar, ku u detyruan të dorëzonin dokumentet e tyre të identifikimit dhe të kalonin në Shqipëri”.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dalin si jo kontestuese edhe faktet se i akuzuari prej vitit 1992 ka punuar në Gjykatën Komunale në Vushtri, në shallterin nr. 6 (që vërtetohen edhe me dëshmitë e dëshmitarëve T.Rr., por edhe disa të tjerë e që konfirmohet edhe nga vetë i akuzuari në procedurat tjera të zhvilluara kundër tij P nr. 67/17 dt. 15.maj 2018), dhe se i akuzuari Z.V. gjatë kohës së konfliktit në Kosovë ishte regjistruar si rezervist i policisë në Vushtri (vërtetohet nga njoftimi i pranuar nga Tribunali i Hagës në rastin Millutinoviq e tj. P02335 i cili njoftim është administruar si provë në shqyrtim gjyqësor).

Kontestues mbetën faktet se veprimet e të akuzuarit Z.V. të përshkruara si më lartë a mund të cilësohen si shkelje të rënda të drejtës ndërkombëtare humanitare, veprime skajshmërisht përçmuese dhe degraduese në formë të shkeljeve të integritetit trupor ose shëndetit dhe shkakimit të vuajtjeve të mëdha, si ka gjetur gjykata e shkallës së parë, apo këto epitete në lidhje me veprimet që janë objekt i aktakuzës dhe aktgjykimit dënues nuk qëndrojnë, ndërsa përfundimet e gjykatës janë të tepruara, të ashpra dhe të padrejta për të akuzuarin, siç pretendon mbrojtja.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari Z.V. rrahu në mënyrë sistematike B.F., S.G., S.G., M.U., F.P., B.M., Sh.M., S.H., A.O., I.F.,

D.F., S.O., S.Rr. dhe R.A. dhe i nënshtrori që të gjithë, si dhe S.K.n, Shefqet Bunjakun dhe G.H., trajtimit çnjerëzor dhe vuajtjeve të pafundme si përmes shkakimit të rrahjeve dhe shkeljeve të integritetit trupor dhe shëndetit ashtu edhe përmes zbatimit të masave të frikësimit dhe terrorit, është i bazuar dhe i mbështetur në provat të sigurta. Kështu që gjykata e shkallës së parë nga dëshmitë e dëshmitarëve S.K.t, S.G., S.G., M.U., G.H., F.P., B.M., Sh.M., A.O., Sh.B., S.H., Beqir, Izet dhe D.F., S.O., S.Rr. dhe R.A., vërtetoi faktet në vijim:

-se i pandehuri kreu rrahje të rënda dhe vepra të keqtrajtimit fizik ndaj personave të përmendur si më lartë (B.F., S.G., S.G., M.U., F.P., B.M., Sh.M., S.H., A.O., I.F., D.F., S.O., S.Rr. dhe R.A.);

- se identifikimi i të akuzuarit si kryerës të veprës penale u vërtetua pa asnjë dyshim. Në fakt, të gjithë dëshmitarët nga Vushtrrija (S.K., S.G., S.G., M.U., B.M., F.P., G.H., Sh.B. dhe R.A.), të akuzuarin e kishin identifikuar si person që e kanë njohur edhe më parë si punëtorë të Gjykatës Komonale në Vushtri, ndërsa dëshmitarët nga fshati Bare (A.O., B.F., D.F. dhe S.O.) nuk e kishin njohur më parë të akuzuarin por emrin e tij e kishin mësuar nga dëshmitarët nga Vushtrria të cilët e kanë njohur edhe më parë, prandaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ua falë besimin këtyre dëshmitarëve në cilat edhe e mbështetë konkludimin e saj

-i akuzuari shkaktoi vuajtje mendore përmes nxitjes së frikës dhe terrorit kundër të gjithë viktimave të lartpërmendura, si dhe ndaj S.K., G.H. dhe Sh.B.;

- dëshmitarët e përmendur ishin viktima të drejtpërdrejta të ngjarjes ose dëshmitarë okular dhe dëshmitë e tyre lidhur me rrethanat e përmendura më lartë ishin pothuaj se të njëjta dhe mbështetshin njëra tjetrën;

-po ashtu u vërtetuan edhe faktet lidhur me mënyrën e veprimit të akuzuarit në kryerjen e rrahjeve (nëse duart tërhiqeshin atëherë ai i godiste në kokë ose në supe) dhe gjithashtu në lidhje me hollësitë karakteristike që i përcjellshin rrahjet, përkatësisht fakti që i pandehuri luante këngë nacionaliste gjatë kryerjes së veprimeve dhe së bashku me rojet e tjera pinte alkool dhe piqte mish;

-faktet lidhur me vendin ku kanë qëndruar dëshmitarët dhe vendin se ku janë rrahur. Pra, të gjithë dëshmitarët kanë folur për qëndrimin e tyre në sallën e TV dhe se rrahjet janë bërë jashtë kësaj sale të TV, afër shkallëve të hyrjes në sallë dhe se ata kanë mundur të shohin ato rrahje nëpërmes dritares së sallës së TV.

Këto fakte të vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë nuk janë vënë në dyshim me pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit e as vetë të akuzuarit. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimi ankimor i mbrojtësit të akuzuarit se përfundimet e gjykatës janë të tepruara, të ashpra dhe të padrejta për të akuzuarin nuk paraqesin arsye që i vënë në dyshim ato përfundime e as arsye që shpjen në konkludim se gjykata gabimisht e ka vërtetuar gjendjen fakti. Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë se dëshmitë e dëshmitarëve të përmendur në rrethanat e ndalimit të tyre dhe personave të tjerë (shqiptarëve) në objektet e

burgut të Smrekovnicës, por edhe në rrethanat lidhur me identifikimin e të akuzuarit Z.V. dhe veprimeve konkrete të tija ndaj këtyre dëshmitarëve në rrethanat e qëndrimit të tyre në burg janë objektive pa ndonjë qëllim ose motiv për të dëshmuar rrejshëm, është i bazuar dhe i drejtë.

Po ashtu, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, pretendimet ankimore të të akuzuarit lidhur me dëshminë e dëshmitarit S.K. dhe R.A., nuk janë të tilla që në çfarëdo mënyre do të ndikonin në ndryshimin e gjendjes faktike të konstatuar nga gjykata lidhur me veprimet inkriminuese të akuzuarit. Prandaj, përfundimet e gjykatës lidhur me vlerësimin e dëshmisë së dëshmitarit R.A. (par. 270 të aktgjykimit të ankimuar), i aprovon edhe kjo Gjykatë si të drejta dhe vlerëson se japin përgjigje në pretendimet ankimore, ndërsa nuk e sheh të arsyeshme që ti përsëris.

Shkeljet e ligjit penal.

Në ankesën e tij mbrojtësit të akuzuarit pretendon se gjykata e shkallës së parë duke i cilësuar veprimet e të akuzuarit si vepër penale –krime lufte ka shkelur ligjin penal në dëm të akuzuarit sepse veprimet individuale të akuzuarit nuk e arrijnë nivelin për shkaktimin e dhimbjeve dhe vuajtjeve të mëdha, si konstatohet në aktgjykimet të cilat prokurori i citon. Sipas ankesës për kushtet në burgun e Smrekovnicës assesi nuk mund të jetë përgjegjës i akuzuari edhe nëse ishte roje në këtë burg, por drejtoria e burgut e nga dëshmitarët e nga dëshmitari i parë është vërtetuar se kush ka qenë drejtor. Me asnjë provë nuk është dëshmuar se i akuzuari V. ishte anëtar i drejtorisë e as që ishte mbikëqyrës i ndokujt.

Pastaj, në ankesë theksohet se sado që sjelljet e përshkruara nga dëshmitarët janë të papranueshme dhe frikësimi i paligjshëm ose dënimi i të burgosurve, kjo nuk shkaktojë lëndime të mëdha me pasoja të përhershme. Në rastin konkret, sipas ankesës, nuk ka prova që dëshmojnë të kundërtën, ndërsa niveli i dhimbjeve fizike, intensiteti i vuajtjeve të shkaktuara, fakti se rrahja e të burgosurve nuk është përsëritur, por kjo ka ndodhur vetëm një herë, se askush nuk ka pasur lëndime trupore e me pasoja të përhershme, flet për atë se veprimet të cilat i vihen në barrë akuzuari nuk janë aq serioze sa të kategorizohen si torturë. Në kontekst të pretendimeve ankimore i referohet Aktgjykimeve të Tribunalit të Hagës për Ruandën (rasti Akajesu) dhe Aktgjykimeve po të njëjtit Tribunal për ish Jugosllavinë (rasti Delaliq e tj).

Po ashtu në ankesë theksohet se ashtu si në këtë rast nuk ka torturë, nuk ka as trajtim çnjerëzorë në kuptim të dispozitave ligjore dhe praktikës relevante gjyqësore në këso rastesh dhe i referohet Aktgjykimeve të Tribunalit Ndërkombëtar në rastet: Delaliq e tj., Irlanda kundër Mbretërisë së bashkuar, Tomasi kundër Francës, Hukli Gunes kundër Turqisë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara për këto arsye:

Gjykata e shkallës së parë duke iu referua veprës penale për të cilën të akuzuarin Z.V. e ka shpallur fajtor (neni 142 lidhur me nenin 22 të KPRSFJ) ka trajtuar secilin element të kësaj vepre penale veç e veç në kontekst të rrethanave që ka ndodhur ngjarja dhe veprimeve konkrete

të akuzuarit, por edhe në drejtim të interpretimit të Drejtës Ndërkombëtare dhe Konventave të përmendura në cilësimin juridik të veprës. Kështu, gjykata trajton çështjen e ekzistimit të konfliktit të armatosur dhe statusit të dëshmitarëve si viktimë, të cilat kjo Gjykatë i aprovon në tersi si të bazuara dhe nuk e sheh të arsyeshme që ti përsërisë sepse ankesat nuk e kanë kundërshtua aktgjykimin në këtë pjesë.

Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar i referohet edhe jurisprudencës së Tribunalit të Hagës lidhur me rrethanat e përmendura më lartë. Kështu, i referohet rastit “Kunarac” në cilin kjo Gjykatë konstatoi se shkelja e së drejtës ndërkombëtare humanitare është serioze nëse përmban: “shkelje të rregullës që mbron vlera të rëndësishme dhe shkelja duhet të këtë pasoja të rënda për viktimën”.

Se veprimet e të akuzuarit kanë pasur pasoja të rënda për viktimën është vërtetuar padysim me dëshmitë e dëshmitarëve si atyre që ishin rrahë dhe keqtrajtuar nga i akuzuari ashtu edhe të atyre që i shikuan ato. Në ankesë theksohet se lëndimet që pretenduan dëshmitarët se i kanë pësuar me këtë rast nuk ishin të tilla që të cilësohen si torturë dhe për to nuk pati asnjë dëshmi konkrete (dokumentacion mjekësor), dhe u referohet vendimeve të Tribunalit Ndërkombëtar të përmendura në pjesën e pretendimeve ankimore. Mirëpo, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate me të drejtë gjykata e shkallës së parë i referohet vendimit të Tribunalit të Hagës në rastin “Kvočka e t.j.” (nr. 55, par. 66) që është specifik për elementet e akteve të dhunës dhe i cili përmban: “Dëmtimi i shëndetit fizik ose mendor do të merret parasysh gjatë vlerësimit të peshës së dëmit të shkaktuar. Keqpërdorimi i barabartë me torturën nuk duhet domosdoshmërisht të përfshijë lëndimin fizik, sepse dëmi mendor është formë përhapur e shkaktimit të torturës. Për shembull vuajtja mendore e shkaktuar ndaj individit i cili është i detyruar të shikojë keqtrajtim të rëndë që i shkaktohet një të afërmi, do të ngritet deri në nivelin e peshës së kërkuar nga krimi i torturës”.

Edhe në rastin “Delaliq e t.j.” (aktgjykimi i dt. 16 nëntor 1998, par. 1086) konstatohet: “të burgosurit vazhdimisht ishin dëshmitarë të abuzimit më të rëndë fizik që u shkaktohej viktimave të pambrojtura. Kjo provë tregon më tutje se si të burgosurit në kushtet e burgimit të një numri të madh njerëzish ishin detyruar të shikonin pa dëshirë dëmtimet dhe vuajtjet e tmerrshme të shkaktuara nga ky keqtrajtim). Po ashtu, në të njëjtin vendim konstatohet të burgosurit në kampin –burgun e Çelebiqit iu ekspozuan kushteve në të cilat jetuan në ankth dhe frikë të vazhdueshme se do ti nënshtrohen keqtrajtimit fizik përmes veprave të shpeshta të egra dhe të dhunshme të kryera në kamp-burg, të rënduar nga natyra e rastësishme e këtyre veprimeve dhe kërcënimeve të bëra nga rojet, të burgosurit i nënshtroheshin një presioni të madh psikologjik i cili mund të karakterizoj me saktësi si atmosferë terrori (paragrafi 1091)”. Ndërsa në rastin “Vasileviq” (aktgjykimit i dt. 29 nëntor 2002, par.235) gjykata konstaton “për të vlerësuar seriozitetin e një akti, duhet ti kushtohet vëmendje të gjitha rrethanave faktike. Këto rrethana mund të përfshijnë natyrën e veprimit ose mosveprimit, kontekstin në të cilin ndodhi, rrethanat personale të viktimës duke përfshirë moshën, gjininë dhe shëndetin, si dhe efektet fizike, mendore dhe morale të veprimit mbi viktimat... ndonëse nuk ka kërkesë që vuajtjet e shkaktuara nga veprimi kanë efekte afatgjatë në viktimën”. Në rastin “Kuarac” gjykata i referohet rastit

Aleksovski (aktgjykimi i dt. 25 qershor 1999, par.49) ku konstatohet “se dhuna kundër dinjitetit personal është akt që është nxitur nga përbuzja për dinjitetin njerëzor të një personi tjetër. Konkluzioni është që akti duhet të shkaktojë poshtërim apo degradim serioz për viktimën. Nuk është e nevojshme që akti të dëmtojë drejtpërdrejt mirëqenien fizike ose mendore të viktimës. Mjafton që akti t’i shkaktojë vuajtje të vërtetë dhe të qëndrueshme individit që vjen nga poshtërimi apo tallja”. Dhe pastaj vazhdon (paragrafi 501) “përderisa poshtërimi apo degradimi është i vërtetë dhe serioz, Dhoma e Gjykatës nuk mund të shohë asnjë arsye pse kjo do të duhej të jetë e qëndrueshme. Sipas pikëpamjes së Dhomës së Gjykatës, nuk është e hapur për të konsideruar faktin se viktima është shëruar, ose është duke i tejkaluar efektet e një veprë të tillë, siç tregohet vetvetiu se aktet përkatëse nuk përmbanin dhunë-dinjitetin personal. Natyrisht, nëse poshtërimi dhe vuajtja e shkaktuar është vetëm e shkurtër nga natyra, mund të jetë e vështirë të pranohet se është e vërtetë dhe serioze. Megjithatë kjo nuk siguron që çdo lloj kërkese minimale kohor e efekteve të një dhune mbi dinjitetin personal është element i veprës”. Në rastin Bllagojeviq dhe Jokiq (aktgjykimi i dt. 17 janar 2005, par.629 deri 630) konstatohet “Mens rea e akteve çnjerëzore plotësohet kur shkelësi, në kohën e veprimit ose mosveprimit, kishte për qëllim të shkaktojë vuajtje të rëndë fizike ose mendore, ose për të kryer sulm të rëndë mbi dinjitetin njerëzor të viktimës ose ku e dinte se veprimi ose mosveprimi i tij ka mundur të shkaktojë vuajtje serioze, fizike ose mendore ose sulm serioz ndaj dinjitetit njerëzor që ishte i pamatur”.

Duke pasur parasysh faktin se gjykata e shkallës së parë padyshim ka vërtetuar se i akuzuari Z.V. rrahu në mënyrë sistematike dhe të ashpër disa të burgosur në Burgun e Smrekovnicës, të ndaluar në rrethanat e përkrahura në pjesën më lartë të aktgjykimit, gjatë një periudhe të gjatë kohore, se nga dëshmitë e dëshmitarëve u vërtetua ashpërsia dhe mënyra mizore në të cilat janë kryer rrahjet (nëse viktima do të ulin dorën, atëherë ata do të rriheshin në kokë ose në shpatullat e tyre), por edhe vet numri i goditjeve të pranura si dhe pasojat që ata kishin pas këtyre rrahjeve (duart ishin të ënjtura, disa prej dëshmitarëve treguan se duart dhe kyçet e tyre ishin të thyera dhe se ende vuajnë nga pasojat e këtyre rrahjeve), janë tregues i mizorisë të veprimeve të akuzuarit dhe vuajtjeve mendore që pësuan viktimat. Në anën tjetër, si është thënë edhe më lartë, viktimat janë mbajtur në sallën e TV, ndërsa janë rrahur jashtë sallës së TV, ku të gjithë të burgosurit mund të shihnin veprimet e vazhdueshme. Përveç rrahjeve sjelljet përcjellëse të të akuzuarit synonin të ndikonin mentalisht ndaj viktimave sepse ai duke lëshuar këngë nacionaliste dhe duke pjekur pish dhe pirë birra derisa viktimat ishin të burgosur në kushte jashtëzakonisht të rënda (u mbajtën pa ushqim disa ditë).

Për më tepër, edhe pse dëshmitarët deklaruan se ishin rrahur vetëm njëherë, gjykata e shkallës së parë me të drejtë përfundon se nga dëshmitë e tyre qartë rezulton se ata nuk e dinin a do të përsëriten rrahjet dhe kur do të ndodh kjo. Kur kemi parasysh faktin se pothuajse të gjithë dëshmitarët janë mbajtur në burgim për një periudhë të gjatë kohore, rrethana të tilla përforcojnë frikën dhe terrorin e tyre se a do të ndodhin dhe kur do të ndodhin rrahje të tjera. Po ashtu, të gjithë dëshmitarët kanë pohuar se i akuzuari Z. ishte më i egri nga të gjithë rojet dhe niveli i terrorit vazhdoj të përsëritej gjatë kohës së ushqimit deri në pikën që disa viktima preferonin ti

linin pa ngrënë shujtat e tyre se sa të përballeshin me të pandehurin. Kjo situatë ka ndodhur edhe me viktimat që nuk ishin objekt i rrahjeve të drejtpërdrejta por që megjithatë vuajtën nga ky mjedis i terrorit (shikonin rrahjet e të tjerëve, por edhe priteshin se edhe ata mund të ishin të rrahur).

Të gjitha këto fakte vërtetojnë se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë: “Se krimet e të pandehurit ishin veçanërisht serioze në aspektin e interesave të mbrojtura që ai shkeli-përkatësisht integritetin fizik dhe mendor të viktimave, pasojat për viktimat (vuajtjet e mëdha fizike dhe mendore që ende mbajnë me vete), mënyrën e veprimit dhe arsyet për të cilat këto krime janë kryer, e që nuk ishin arsye tjera përveç urrejtjes së dukshme etnike. Urrejtja etnike, e cila u theksua edhe në gjithë modus operandin e përmendur më lartë ku i pandehuri lëshonte këngë nacionaliste gjatë kryerjes së rrahjeve dhe i thërriste viktimat në bazë të vendit nga vinin dhe ishte veçanërisht i egër ndaj një grupi të caktuar njerëzish (nga fshati Bare, pasi që kishte supozime se një i afërm i të pandehurit ishte vrarë në atë rajon), del i drejtë dhe i pa kontestueshëm.

Prandaj, duke pasur parasysh rrethanat e sipër përmendura si dhe rrethanat dhe arsyet e cekuramë detaisht në aktgjykimin e ankimuar, rezultojnë si të drejta dhe të ligjshme përfundimet e gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari Z.V. ka kryer veprën penale për të cilën edhe është shpallur fajtor. Në këto rrethana formohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të qenies së veprës penale-krime lufte kundër popullatës civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të KPRSFJ, ndërsa pretendimet ankimore dalin të pabazuara.

Vendimi për dënim.

Prokuroria në ankesën e saj aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën dënuese (aktakuza III) e kundërshton për shkak të vendimit për dënimin me pretendim se:” Për pikën e aktakuzës në të cilën gjykata ka marrë aktgjykim dënues, vlerësojmë se dënimi i shqiptuar aspak nuk i përgjigjet peshës së kryer të veprës penale, rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, kohën dhe kontekstin e kryerjes së veprës penale, mënyrën e vrazhdë e kryerjes së veprës penale ndaj civilëve të pafajshëm dhe të paarmatosur, rrethanën se disa nga viktimat ishin të mitur, disa nga ata pleq, e kështu me rradhë, si dhe sjelljen e kryesit gjatë kryerjes së veprës penale i cili nuk tregoj aspak mëshirë për lutjet e nënave që mos t’iu vrajë fëmijët, Po ashtu nuk duhet harruar faktin se ndikimi dhe efektet të cilat japin veprat penale të krimeve të luftës është shumë i madh se çdo vepër penale e cila kryhet në kohe paqe, andaj edhe mesazhi me rastin e dhënies së dënimeve duhet të jetë proporcional me pasojat dhe efektet negative të cilat këto vepra penale shkaktojnë jo vetëm për viktimat dhe kryesin e kësaj vepre penale, por edhe më gjerë, krejt kjo me qëllim që të parandalohen veprat të tilla të cilat konsiderohen edhe turp për njerëzimin”.

Ndërkaq mbrojtësi i të akuzuarit në ankesën e tij lidhur me vendimin për dënimin pretendon se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i padrejtë dhe shumë i ashpër dhe me kusht që vërtetohet se i akuzuari i ka kryer veprimet si në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktgjykimit, ky dënim

është shumë i lartë dhe nuk është në baraspeshë me fajësinë e të akuzuarit. Kjo sidomos vjen në shprehje nëse bëjmë krahasimin e dënimit të shqiptuar të akuzuarit me dënimet të cilat në raste të ngjashme janë shqiptuar nga Tribunali i Hagës për ish Jugosllavinë dhe me këtë rast u referohet dënimeve të shqiptuar nga ky Tribunal: Zlatko Aleksovski, Predrag Bozhoviq, Rasim Deliq, Mario Qerkez, Millan Siniq, Damir Doshen, Dragan Kollungjia, Miroslav Kvočka, Draguljb Përcaq, Millojica Kos dhe thekson se të gjithë ata sipas aktgjykimeve në Hagë ishin komandantë të kampeve, drejtorë të burgjeve, ndihmës ose zëvendës të shefave të ndrrimit dhe komandantë të rojës së burgjeve, mirëpo siç shihet nga këto aktgjykime dënimet janë shumë më të ulëta se dënimi i shqiptuar të akuzuarit.

Pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë të akuzuarit Z.V. me rastin e matjes dhe përcaktimit të dënimit i ka marrë parasysh si rrethanë rënduese: numrin e viktimave, faktin se veprimet e të pandehurit përbënin disa akte të ndara, faktin se viktimat janë nënshtruar këtyre akteve gjatë një periudhe të zgjatur kohore dhe faktin se terrori ishte shkaktuar në mënyrë të përhershme dhe gjithashtu në njerëz që nuk ishin objekt të rrahjeve. Si rrethanë lehtësuese mori: mungesën e dosjeve penale, dhe faktin që i pandehuri ka kryer një jetë të mirë profesionale.

Vlerësimin e këtillë të rrethanave për matjen e dënimit, si të drejtë e aprovon edhe Gjykata e Apelit, e cila vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe është në funksion të preventivës së përgjithshme, posaçërisht asaj të posaçme dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK-së. Për një dënim më të ulët nuk janë plotësuar kushtet ligjore, e duke pasur parasysh edhe faktin se në ankesë nuk theksohen rrethana individuale të akuzuarit që do të arsyetonin dënimin më të ulët. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimi ankimor se me shembujt nga vendimet e Tribunalit Ndërkombëtar për ish Jugosllavin tregojnë se në raste të ngjashme janë shqiptuar dënime shumë më të buta se që i është shqiptuar të akuzuarit, janë të pabazuara sepse gjykata me rastin e caktimit të dënimit për vepër penale duhet të ketë parasysh si minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për atë vepër penale ashtu edhe qëllimin e dënimit dhe rrethanat tjera lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar dhe pastaj bënë individualizimin e dënimit në raport me peshën e veprës penale dhe me sjelljet dhe rrethanat e kryerësit, që do të thotë se vendimet e përmendura nga mbrojtja mund të jenë orientuese, por assesi përcaktuese me rastin e matjes së dënimit të akuzuarit.

Po ashtu pretendimet ankimore të për një dënimin më të ashpër nuk janë të bazuara, sepse në ankesë kryesisht u referohet rrethanave që paraqesin elementet e veprës penale, ndërsa rrethanat tjera tani veç janë vlerësuar drejtë nga gjykata e shkallës së parë.

I akuzuari në ankesë përveç që propozon që ti shqiptohet një dënimim më i butë nuk ka paraqitur asnjë arsye konkrete që ndikon në matjen e dënimit.

I akuzuari Z.V. aktgjykimin e kundërshton edhe përkitazi me kërkesat pasurore juridike të parashtruara nga palët e dëmtuara edhe pse me aktgjykimin e shkallës së parë të gjitha këto kërkesa janë hedhë si të pambështetura në prova konkrete dhe si të tilla janë të pabazuara, ndërsa nuk janë kundërshtuar nga palët. Prandaj, duke pasur parasysh faktin se gjykata i ka hedhë kërkesat e palëve të dëmtuara për kompensimin e dëmit, kjo gjykatë nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve të paraqitura nga i akuzuari sepse gjykata e shkallës së parë ka dhënë përgjigje lidhur me këto kërkesa.

II

Pretendimet ankimore për pjesën liruese të aktgjykimit të ankimuar.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës me ankesë pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë në pjesën liruese (dispozitivi I –akuza I), është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale parashikuar me nenin 384 par.1 pika 1.12, sepse aktgjykimi i ankimuar nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të KPPRK-së, më saktësisht sipas paragrafit 7 të këtij neni, të cilat shkelje janë pasoi e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Në kontekst të shkeljeve të përmendura ankesa i referohet deklaratave të dëshmitarëve N.G., B.A., R.M., H.A., M.G., B.A., me pretendim se nga dëshmitë e tyre në mënyrë të plotë vërtetohet gjendja faktike nga pika I e aktakuzës.

Duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas pretendimeve ankimore, por edhe sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 par. 1 të KPPK-së, Gjykata e Apelit, gjen se ky aktgjykim, ashtu si me të drejtë pretendon Prokurori është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nën par. 1.12, të KPPK-së, sepse nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 të KPPK-së. Në fakt, nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare, ndërsa ato që janë dhënë janë të paqarta, në masë të konsiderueshme kontradiktore dhe për tani të papranueshme, mbi faktet vendimtare ekziston kontradiktë e konsiderueshme midis asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit me përmbajtjen e dokumenteve ose procesverbaleve, posaçërisht me deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në polici, pastaj në prokurori dhe në fund në shqyrtim gjyqësor, që aktgjykimin e bëjnë të pakuptueshëm dhe kundërthënës që domosdoshmërisht kushtëzuan anulimin e tij dhe kthimin e çështjes në rivendosje.

Kështu, nga përmbajtja e aktgjykimit të ankimuar del se me rastin e marrjes së aktgjykimit lirues, gjykata e shkallës së parë arsyetimin e aktgjykimit e ndan në kapituj duke iu referua vrasjeve që kanë ndodhur në ngjarjen e përshkruar nga dëshmitarët me ç'rast edhe i vlerëson provat-dëshmitë e dëshmitarëve konkret. Kështu në pjesën lidhur me vrasjen e E. dhe Xh.M., E.R. dhe F.G. aktgjykimin lirues e mbështetë përveç në mbrojtjen e të akuzuarit edhe në dëshminë e dëshmitarëve N., Sh. dhe M.G., pastaj vrasjen e A.B. në dëshmitë e N., Sh. dhe M.G., vrasjen e 14 vjetarit të pidentifikuar në dëshminë e N., Sh. dhe M.G. dhe vrasjen e R.A. dhe tentim vrasjen

e H.A., në dëshminë e B., B.2 dhe H.A. dhe në funde vrasja e B.(B.2 dhe A.G., në dëshminë e dëshmitarit I.P..

Pra, siç rezulton nga përmbajtja e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë aktgjykimin lirues përveç në mbrojtjen e të akuzuarit e mbështetë edhe në dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna në shqyrtimin gjyqësor, por pa dhënë arsye të mjaftueshme dhe konkrete përse gjykata nuk i ka marr parasysh deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në fazat e mëparshme të procedurës paraprake, në polici dhe prokurori, të cilat janë dhënë në një kohë relativisht të shkurtër pas ngjarjes kritike, kur edhe dëshmitaret e kanë pasur memorien e freskët dhe kanë qenë më të sigurt në deklaratimet e tyre për ngjarjet e luftës, por edhe lidhur me kryerësit, gjegjësisht identifikimin e të akuzuarit sepse janë dhënë pas disa muajve ose pak vjet pas luftës.

Për më tepër, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit konstaton se të gjithë dëshmitarët të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor ishin dëgjua edhe në fazat paraprake në polici (duke përfshirë Njësinë për hetimin e krimeve të luftës të EULEX) ose në Prokurori dhe konstaton (paragrafi 69 i aktgjykimit):”Gjatë gjykimit aktual Trupi gjykues vuri në dukje se lidhur me pikën I të aktakuzës, dëshmitarët e njëjtë duket se kanë zbutur përshkrimet e tyre të mizorive që kishin deklaruar më herët se kishin kaluar dhe/ose rolin që i pandehuri ka luajtur aty. Asnjë shpjegim i kënaqshëm nuk është dhënë për këto dallime, dhe as Trupi gjykues nuk ka gjetur asnjë tregues konkret të presionit mbi dëshmitarët, qoftë nga ana e prokurorisë gjatë deklaratimit të tyre të mëparshëm ose nga mbrojtja përpara ose gjatë shqyrtimit gjyqësor”, për të vazhduar në paragrafin 70 ‘se është një fakt i njohur që me kalimin e kohës edhe kujtimet më të dhimbshme kur nuk rifreskohen rregullisht, tentojnë të zbehen’.

Mirëpo, edhe përkundër këtyre konstatimeve të përgjithësuara, gjykata e shkallës së parë fare nuk i ka trajtuar, gjegjësisht nuk i ka vlerësuar dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna në fazat e mëhershme të procedurës penale e as që ka dhënë arsye se në çka konsistojnë mospërputhjet sepse pikërisht në këto mospërputhje qoftë në mes deklaratimeve të dëshmitarëve të dhëna në procedurën paraprake (të cilat fare nuk i vlerëson) dhe atyre në shqyrtimin gjyqësor e mbështetë konkludimin lidhur me faktet vendimtare për identifikimin e të akuzuarit gjatë kohës kritike, praninë e tij në vendin e krimit dhe veprimet e tij edhe pse dëshmitarët në shqyrtimin gjyqësor kishin deklaruar se mbetën pran deklaratimeve të dhëna me parë në polici dhe prokurori. Ky konstatim është plotësisht në kundërshtim me konkludimin e gjykatës për vlerësimin e dallimeve në dëshmitë e përmendura :” se me kalimin e kohës edhe kujtimet më të dhimbshme kur nuk rifreskohen rregullisht, tentojnë të zbehen”, ndërsa, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pikërisht ky fakt është dashtë të merret parasysh nga gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të besueshmërisë së dëshmitarëve duke i vlerësuar jo vetëm dëshmitë e tyre të dhëna në shqyrtim gjyqësor në mënyrë selektive, por edhe në raport me dëshmitë e mëparshme dhe pastaj, ashtu si edhe parashikon dispozita e nenit 361 të KPRK, të nxjerrë përfundim.

Përveç kësaj, arsyet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë lidhur me faktet vendimtare se a ishte i pranishëm i akuzuari në ngjarjet e që kanë ndodhur dhe a kishte vepruar së bashku me personat tjerë ndaj të dëmtuarve dhe viktimave sipas përshkrimit faktik në aktakuzën në pikën I (dispozitivi nën pikën I të aktgjykimit), janë në kundërshtim me përmbajtjen e dokumenteve ose procesverbaleve, posaçërisht me deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në polici, pastaj në prokurori dhe në fund në shqyrtim gjyqësor, si me të drejtë pretendon edhe Prokuroria në ankesën e saj.

Nga arsyetimi i aktgjykimit rezulton se dëshmitari N. G. në gjitha fazat e procedurës penale ka dëshmuar për ngjarjen në mes 2 dhe 3 majit të vitit 1999 duke përshkruar kolonën e Studimës, mjetin me të cilin ishin duke udhëtuar, personat që ishin me të , por edhe për personat tjerë që udhëtonin në të njëjtën kolon e pastaj edhe për vrasjen e E. M., Xh.M., E.R. dhe F.(A.)G. duke identifikua edhe personat që i kryen këto veprime. Ky dëshmitarë shumë qartë e ka identifikua të akuzuarin Z.V. si nga rrobat që kishte veshur ashtu edhe si personin që e ka njohur edhe më parë dhe me të cilin kishte punuar në Kompaninë e ndërtimit të Kosovës, por më vonë edhe si punëtorë në Gjykatën Komunale dhe pastaj si policë dhe me të cilin kishte komunikuar, si person që së bashku me Aca Kompiroviq i kanë detyruar E. M. dhe Xh.M. të zbresin nga rimorkio, por edhe E.R. dhe F.(A.)G. të cilët pastaj i ekzekutuan por nuk din se cili nga këta dy e ka kryer ekzekutimin. Gjykata nuk ia falë besimin këtij dëshmitari sepse dëshmitarët Shaip dhe M.G. fare nuk i përmenden këto vrasje edhe pse ishin të pranishëm në të njëjtën ngjarje, por gjykata nuk jep arsye lidhur me dëshminë e dëshmitarit M.G. (procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 11.11.2017), i cili po ashtu e ka përshkruar detaisht të akuzuarin dhe e ka identifikuar se ishte i pranishëm në ngjarjen që ka ndodhur në mes të 2-3 majit 1999. Gjykata e shkallës së parë nuk jep arsye as për deklaratat e dëshmitarëve tjerë të cilët e kanë identifikuar të akuzuarin si person i veshur si milic ishte në vendin e ngjarjes dhe të cilin e kishin njohur edhe më parë me emër dhe mbiemër. Dëshmitarët B.A., R.M., H.A., B.A. etj. kanë përshkruar përveç veshjes dhe karakteristikave tjera fizike të akuzuarit edhe veprimet konkrete që ka ndërmarrë ndaj tyre apo personave tjerë që ishin në kolon. Mirëpo, gjykata dëshmitë e dëshmitarve i vlerëson në mënyrë selektive duke i nxjerr nga konteksti i dëshmisë ndonjë fakt që nuk e kanë përmendur ndonjëri prej tyre dhe kjo i mjafton për të vlerësuar një dëshmi si të pabesueshme.

Për këto arsye, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, përfundimi i gjykatës se dëshmitë e dëshmitarëve përbëjnë dyshime serioze për identifikimin e të akuzuarit dhe praninë e tij në vendin e krimit, janë në kundërshtim me dëshmitë e përmendura, ndërsa gjykata e shkallës së parë për të arsyetuar konkludimet e saj lidhur me vlerësimin e dëshmimeve të dëshmitarëve fare nuk e merr për bazë konstatimin e saj (të cituar më lartë) se për shkak të kalimit të kohës kujtimet mund të zbehen e as kontekstin psikologjik në cilin ishin dëshmitarët (disa prej cilëve ishin edhe objekt i veprimeve konkrete H.A.), por pikërisht zbehja e këtyre kujtimeve pa vlerësim të gjithanshëm të gjithë provave të rastit konkret (të gjitha dëshmimeve polici, prokurori dhe gjykatë) ishin arsye për mos besueshmërinë e tyre (dëshmimeve), si në rastin e dëshmitares R.M.). Në fakt, gjykata e shkallës së parë kur jep arsye për rrethanat që kanë të bëjnë me identifikimin e të akuzuarit Z.V., nuk merr fare parasysh deklaratat e dëshmitarëve në fjalë edhe pse nga këto deklarata del se disa prej dëshmitarëve (shumica prej tyre) në mënyrë pothuajse identike e kanë

bërë përshkrimin e disa personave që ish në vendin e ngjarjes, e disa edhe nëpërmes fotografive në mesin e të cilave ishte edhe i akuzuari Z.V., por edhe në shqyrtim gjyqësor ata e identifikuan qartë të akuzuarin si person që ishte në vendin e ngjarjes. Prandaj, mbetet e paqartë se cilat ishin arsyet konkrete që gjykata e shkallës së parë nuk ua fali besimin dëshmitarëve të cilët ishin dëshmitarë okular të ngjarjes, disa të plagosur (H.A.)dhe disa që personalisht e kanë njohur të akuzuarin me të cilin kanë punuar dhe kanë komunikuar gjatë punës (H.G.), ose si punëtorë të gjykatës ose si policë në rrugë (B.A. dhe R.M.). Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, arsyet e gjykatës së shkallës së parë përkritazi me vlerësimin e dëshmitarëve i bënë të paqarta sidomos fakti se gjykata ua fal besimin këtyre dëshmitarëve lidhur me ngjarjen që ka ndodhur, vrasjet e përmendura, por nuk ua falë besimin vetëm lidhur me identifikimin e të akuzuarit edhe pas, si u tha më lartë, shumica prej tyre e kanë identifikuar pa asnjë dyshim në mënyrën e përshkruar si më lartë.

Nga arsyet që u thanë më lartë kjo Gjykatë gjen se arsyet përkritazi me faktet vendimtare që ka dhënë gjykata e shkallës së parë janë të paqarta, kundërthënëse në masë të konsiderueshme dhe në kundërshtim me shkresat e lëndës lidhur me deklaratimet e dëshmitarëve që në rastin konkret bëjnë që aktgjykimi i ankimuar të jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 të KPK-së, prandaj ky aktgjykim juridikisht është i paqëndrueshëm për ç'arsye u deshtë të anulohet dhe të kthehet në rigjykim.

Përkritazi me bazat ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të Prokurorit, në pjesën liruëse, janë të bazuara, nga se shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të paraqitura si më lartë janë ngushtë të ndërlidhura edhe me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe që padyshim drejtpërdrejtë ka ndikuar edhe në aplikimin e gabuar të ligjit penal dhe si pasojë e kësaj është shkelur ligji penal.

Me rastin e rigjyimit, gjykata e shkallës së parë, duhet ti mënjanojë shkeljet esenciale të cekura e theksuara të dispozitave të procedurës penale, pastaj lëshimet lidhur me vërtetimin dhe vlerësimin e drejtë të gjendjes faktike si dhe zbatimin e drejtë të ligjit penal. Gjithashtu, me këtë rast duhen të mirën në konsideratë edhe pretendimet tjera ankimore për gjendjen faktike dhe zbatimin e ligjit penal të cekura në ankesën e prokurorisë Speciale të republikës së Kosovës. Duke u bazuar në të gjitha këto ti administrojë edhe një herë të gjitha provat e propozuara dhe me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera në këtë çështje posaçërisht deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në gjitha fazat e procedurës penale dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerr aktgjykimin të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penale.

Nga sa u tha më lart, konform nenit 401 dhe 402 par. 1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.471/2018 me datë 30 janar2019,

Procesmbajtësi:

Sadik Kryeziu

Anëtarët e kolegjit:

Tonka Berishaj

Have Haliti

Kryetari i kolegjit:

Fillim Skoro